



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration


Për :	Ragip Begaj , Kryetar i Komunës së Malishevës Rrahim Morina , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević , Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj , Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi , Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL	Datë: 15.03.2018
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës	Nr. 020-338
Lloji i aktit	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02/35 për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018
I miratuar më datë: 02.03.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.03.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Ragip Begaj, gradonačelnik Opštine Mališevo Rrahim Morina, predsedavajući Skupštine opštine Mališevo		
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini		
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>za. št. [signature]</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a, <i>[signature]</i>		
Od:	Shkelqim Jakupi, rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS - <i>[signature]</i>	Datum,	15.03.2018 Br. 020-338
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Mališevo		
Vrsta akta:	Odluka		

Poštovani gradonačleniče,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 02/35 za usvajanje plana rada skupštine opštine za 2018
Usvojena dana, 02.03.2018. godine;
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 07.03.2018. godine;

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 07.03.2018

Mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 pika d, nenin 40 paragrafi 2 pika d, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe bazuar në Statutin e Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë: 28.02.2018 mori këtë;

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2018

1. Miratohet Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2018

2. Mbështetur në pikën 2 të këtij vendimi Plani i punës së Kuvendit të Komunës do të jetë:

Janar	Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Themelimi i komiteteve obligative; a. Komitetin për Politikë dhe Financa b. Komitetin për Komunitete Formimi i Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018.
Shkurt	Mbledhja solemne për 17 Shkurtin, Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Miratimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018 . Themelimi i Komiteteve jo obligative; - Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport - Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të kufizuara - Komiteti për Familje të Dëshmorëve, familje të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve të Luftës së UÇK-së si dhe të Martirëve të Luftës. - Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Turizëm, mbrojtje të Mjedisit dhe monitorim të projekteve publike. - Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Formimi i Komisioneve; - Komisioni Komunal i Aksionareve - Komisioni vlerësues, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme publike. - Komisioni për ankesa, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës. - Formimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Malishevës. a. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2017. b. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për mënyrën e pagesës për shpenzimet e varrimit për vitin 2018. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës për pajisje me dokumente dhe Qendra për regjistrim të Automjeteve.

HYRËE-ULAZNA-INCORING
REPUBLICAN & LOCALS AFFAIRS PUBLICS PEOPLE'S REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVES VLADA POLTICA GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

Data
07.03.2018

Numri i dokumentit
-VI- 020-338

	Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit për banim social në Malishevë. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sportit në Fshatin Drenoc Plani i Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2018. Informimi nga DKAE, për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2017/18 Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale për vitin 2018. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
Mars	Mbledhja solemne për nder të 5,6,7 Marsit Ditët e Epopesë së UÇK-së. Raporti Vjetor i Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale (Janar-dhjetor) 2017. Plani i Punës i Zyrës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2018. a. Shqyrtimi i raportit të Punës së Qendrës për Punë Sociale për vitin 2017. b. Plani i Punës së Qendrës për Punë Sociale për vitin 2018. Shqyrtimi dhe miratimi i planeve të punës të Komiteteve jo obligative. Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Komunikim dhe Informim në Komunën e Malishevës 2017-2021, dhe Plani i veprimtimit për transparencë. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
Prill	Shqyrtimi i Raportit të detajuar i punës së Zyrës së Tatimit në Pronë për vitin 2017. Shqyrtimi i Raportit Financiar tremujor Janar-Mars për vitin 2018. Shqyrtimi i Raportit të Detajuar i Punës së Drejtorisë për Urbanizëm për vitin 2017. Debat publik mbi qeshtjet e barazisë gjinore në Institucionet publike të Komunës së Malishevës. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të integritetit në Komunën e Malishevës. Zbatimi i planit komunal për efikasitet të energjisë. Zbatimi i planit për banim social. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
Maj	Formimi i Këshillit Organizativ për krenimin e 16 Qershorit 2018, Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë për mbjelljet pranverore për vitin 2018. Shqyrtimi i Raportit të Punës i DKRS, për periudhën Janar-Maj 2018. Shqyrtimi dhe miratimi Planit Zhvillimor Komunal për Komunën e Malishevës. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
Qershor	Shqyrtimi dhe miratimi për ndarjen e dekoratave dhe titujve të nderit. Mbledhja solemne për 16 Qershorin 2018, Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Rishikimi i Buxhetit për vitin 2018. Informatë për përgatitjen e korrje-shirjeve nga Drejtoria për Bujqësi Përgatitjet për pritjen e bashkatdhetarëve të Komunës së Malishevës. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
Korrik	Raporti Gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017. Shqyrtimi i Raportit Gjashtëmujor të Punës i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
Gusht	Informimi nga DKAE, për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 Shqyrtimi i Projekt-Buxhetit për vitin 2019. Shqyrtimi i Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2019.

	Informimi nga Drejtoria e Bujqësisë për përfundimin e korrje-shirjeve. Informimi nga DKAE, për fillimin e vitit shkollor 2018/2019, si dhe Raporti për fillimin e vitit shkollor 2018-2019. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
Shtator	Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Buxhetit për vitin 2019. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2019. Paraqitja e Raportit nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim Janar-Shator 2018 Paraqitja e Raportit të Punës për Periudhën Shkurt-Shtator i Komisionit të Aksionarëve. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
Tetor	Shqyrtimi i Raportit Nëntëmujor Financiar për vitin 2018. Informimi nga Drejtoria për Bujqësi rreth mbjelljeve vjeshtore dhe ndarjes së subvencioneve. Raporti i DKAE-së për përgatitjet dimërore nëpër shkolla. Informimi nga Kryetari i Komunës, dhe Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për mbështetjet e familjeve të varfra. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
Nëntor	Mbledhja solemne për 28 Nëntorin 2018. Informimi nga Drejtoria për Urbanizëm për realizimin e projekteve kapitale 2018. Formimi i Komisionit për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2019. Informimi nga Drejtoria për Inspektorat rreth punës për periudhën Janar-Nëntor 2018. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.
Dhjetor	Informimi për realizimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2018. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019. Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.

- Kuvendi i Komunës përveç pikave të paraqitura si në pikën 1 të këtij vendimi, në Planit e Punës për vitin 2018, mund të shqyrtoj edhe çështje tjera sipas nevojës së ekzekutivit të Komunës.
- Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kuvendi i Komunës, përmes Organeve kompetente.
- Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
Arkivit të Komunës
MAPL-së.

